



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Plannat / Dorezuar Primeshje / Prudato Received / Delivery	04.12.2020	viti god year	
Organ / Shënia Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKPMESHCK	2972/2020		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.315/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A. Nr.315/2020 të datës 22.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] më adresë Ministria e Punëve të Brendshme, Ndërtesa e Rilindjes kati i III, në Prishtinë, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme /Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të shqyrtoj çështjen ankuesit duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- II. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme /Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- IV. Vendimi hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi i emëruar me Vendimin e datës 22.03.2011 të Ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, si anëtar në Sekretarinë për Mbështetje Administrative të Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues dhe të Komisionit për Vlerësimin e Kriterëve për Zgjedhjen në Pozita të Larta

Drejtuese, pas ndalesës së pagesës shtesë në pagë të miratuar me Vendimin Nr.22 të datës 20.10.2011, bazuar në e-mailin e Zyrës së Personelit të datë 10.09.2020, ka parashtruar ankesë me Nr.Prot: 2184/2020 datë 22.10.20 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.10.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. MPB-ja më datë 04.11.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë dhe shkresat e lëndës me faqe 01/12.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:2184/2020 të datës 22/10/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 22.03.2011; Vendimi i datës 20.10.2011; E-mailat zyrtar të datës 10.09.2020; Emaili zyrtar i datës 08.09.2020; Kërkesa për përgjigje e datës 28.10.2020; përgjigja në kërkesë e datës 04.11.2020; Emali zyrtar i datës 03.09.2020; Akt emërimi i ankuesit i datës 21.08.2013; Lista e pagës për ankuesin e datës 30.09.2020; Emaili zyrtar i datës 11.11.2020 si dhe Vendimi i datës 30.10.2020, emaili/kërkesa dërguar sekretarit të MPB-së i datës 02/12/2020, përgjigja në kërkesë përmes emailit e datës 03/12/2020 dhe autorizimi Nr.925/2020 i MPB-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar ë çështja të kthehet në *RISHQYRTIM*, dukë e obliguar Ministrinë e Punëve të Brendshme/Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme që ta trajtoj çështjen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se ndalimi i kompensimit sipas vendimit Nr.22. të datës 20.10.2011 është bërë përmes e-mailit të Menaxherit të Personelit, e që emaili nuk është akt administrativ dhe as nuk ka formën e as përmbajtjen e aktit administrativ dhe se menaxheri i Personelit nuk ka autorizim ligjor dhe nuk është organ përgjegjës për të ndalur të drejtën e pagesës shtesë.

Nga shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se me Vendimin e datës 22.03.2011 të Ministrit të Ministrisë së Administratës Publike është themeluar Sekretaria për Mbështetje Administrative të Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues dhe të Komisionit për Vlerësimin e Kriterëve për Zgjedhjen në Pozita të Larta Drejtuese, ku si anëtar i këtij komisioni është caktuar edhe ankuesi [REDACTED]

Me vendimin Nr.22 të datës 20.10.2011 të Kryesuesit të Këshillit për Pozita të Larta Drejtuese, anëtarëve të Sekretarisë për mbështetje administrative të Komisionit për Vlerësimin e Kriterëve për Zgjedhjen në Pozita të Larta Drejtuese, është miratuar shtesa në pagë në vlerë prej 100 Euro në muaj, në bazë të këtij vendimi ankuesi ka marrë pagesën shtesë në vlerën sipas pikës 1.2 të vendimit deri në muajin Gusht 2020.

Menaxheri i Personelit përmes emailit zyrtar, më datë 10.09.2020, duke u bazuar në sqarimet e marra nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik ka kërkuar që të ju hiqet shtesa anëtarëve të Sekretarisë për Pozita të Larta.



Kolegji nga analizimi dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Vendimi i datës 22.03.2011 i Ministrisë së Ministrisë së Administratës Publike për Themelimin e Sekretarisë për Mbështetje Administrative të Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues dhe të Komisionit për Vlerësimin e Kritereve për Zgjedhjen në Pozita të Larta dhe Vendimi Nr.22 të datës 20.10.2011 për pagesën shtesë në paga për anëtarët Sekretarisë ende nuk janë shfuqizuar me një vendim tjetër nga organi përgjegjës, andaj te dy këto vendime prodhojnë efektet juridike deri sa nuk anulohen apo shfuqizohen sipas detyrës zyrtare ashtu siç përcaktohet me nenin 51 paragrafi 4 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me te cilin shprehimisht thuhet *"Një akt administrativ do të prodhojë pasojë juridike për atë kohë sa nuk është anuluar apo shfuqizuar sipas detyrës zyrtare apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve juridike administrative apo gjyqësore"*


Kolegji për shqyrtim dhe vendosje të ankesave konstaton se Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e ndaljes së shtesave anëtarëve të Sekretarisë për Mbështetje Administrative të Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues dhe të Komisionit për Vlerësimin e Kritereve për Zgjedhjen në Pozita të Larta Drejtuese është dashur të veproj në përputhje me nenin 57 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton: *"1. Një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj, pa rënë kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni"*, si dhe nenin 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë"*.

Ndërsa kolegji vlerëson se me qenë se sipas shkresës/emailit të datës 03/12/2020 është konfirmuar nga zyra e sekretarit të MPB-së se tashmë është autorizuar një drejtor brenda institucionit të MPB-së që të kryejë detyrat e drejtorit të departamentit për menaxhimin e zyrtarëve publik konformë ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publik atëherë konsiderojmë se ka bazë të mjaftueshme që MPB-ja, të merret konkretisht me rishqyrtimin e kësaj ankese konformë dispozitave ligjore që janë në fuqi dhe që rregullojnë këtë çështje konkrete.

Duke marr parasysh gjendjen faktike dhe bazën ligjore të lartcekura, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme është i obliguar të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe të njëjtin ta bëjë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.315/2020, datë 04/12/2020

Hysni Mustafa

Procesmbajtës

Arben Mehmeti

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit z. [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së